

DUKE FORCUAR
SHOQËRINË CIVILE
NË TË GJITHË BOTËN



INDEKSI I QËNDRUESHMËRISË SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE 2021

SHQIPËRIA
TETOR 2022



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

ICNL
INTERNATIONAL CENTER
FOR NOT-FOR-PROFIT LAW

fhi360
THE SCIENCE OF IMPROVING LIVES

INDEKSI I QËNDRUESHMËRISË SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE 2021

Për Shqipërinë
Tetor 2022

Zhvilluar nga:

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
Byroja për Demokracinë, Konfliktin dhe Asistencën Humanitare
Qendra e Ekselencës për Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisjen

Mirënjohje: Ky publikim u mundësua me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. AID-OAA-LA-17-00003.

Shënim: Mendimet e shprehura janë të panelistëve dhe hulumtuesve të projektit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose FHI 360.

MIRËNJOHJE

Ky botim nuk do të ishte i mundur pa kontributin e shumë individëve dhe organizatave. Ne u jemi veçanërisht mirënjohës partnerëve tanë zbatues, të cilët luajtën rolin kritik të lehtësimit të paneleve të ekspertëve dhe shkrimit të raporteve kombëtare. Dëshirojmë gjithashtu të falënderojmë shumë përfaqësues të OSHC-ve dhe ekspertë, partnerë të USAID-it dhe donatorë ndërkombëtarë që morën pjesë në panelet e ekspertëve në secilin shtet. Njohuritë, perceptimet, idetë, vëzhgimet dhe kontributet e tyre janë themeli mbi të cilin bazohet ky Indeks.

PARTNERI VENDAS

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Megi Reçi
Daniel Prroni

MENAXHERËT E PROJEKTIT

FHI 360

Michael Kott
Eka Imerlishvili
Alex Nejadian


QENDRA NDËRKOMBËTARE PËR LIGJIN E SEKTORIT JO FITIMPRURËS (ICNL)

Catherine Shea
Jennifer Stuart

KOMITETI EDITORIAL

Erin McCarthy, Michael Kott, Jennifer Stuart, dhe Kristie Evenson

QËNDRUESHMËRIA E OSHC-VE: 3.7



Në prill të vitit 2021 Shqipëria mbajti zgjedhjet parlamentare, në të cilat Partia Socialiste fitoi mandatin e tretë radhazi. Ndërsa Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) konstatoi se zgjedhjet ishin përgjithësisht të organizuara mirë, OSHC-të kritikuan zbatimin selektiv të sanksioneve për tubime të paligjshme dhe keqpërdorimin e burimeve dhe funksioneve shtetërore nga partia në pushtet dhe figura të tjera publike. Gjithashtu, sipas raportit të Freedom House *Vendet në Tranzicion 2022*, u raportuan pretendime të besueshme për blerje votash, frikësim dhe dhunë, duke dëmtuar integritetin e zgjedhjeve. Disa javë para zgjedhjeve, u publikua në internet një databazë me të dhënat personale të 910,000 zgjedhësve, e cila përmbante edhe preferencat e supozuara politike të tyre, duke ngritur shqetësime se votuesit mund të jenë të cënueshëm nga presioni politik.

Liria e medias në Shqipëri u përkeqësua seriozisht gjatë vitit 2021. Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit (WPFI), media ishte subjekt i presionit të shtuar politik dhe përpjekjeve për të kontrolluar informacionin gjatë pandemisë në vazhdim dhe zgjedhjeve. Krahasuar me një vit më parë, Shqipëria ra me njëzet vende në WPFI në 2021.

Shqipëria vijoi të menaxhojë ndikimet negative sociale dhe ekonomike të pandemisë COVID-19 në vazhdim, si dhe procesin e rindërtimit që pasoi tërmetin e vitit 2019. Kufizimet në grumbullime dhe lëvizje mbetën në fuqi ndërkohë që procesi i vaksinimit vijoi. Sipas raportit të Komisionit Evropian (KE) për vitin 2021, shoqëria civile ofroi mbështetje dhe shërbime për njerëzit më vulnerabël të prekur nga pandemia COVID-19.

Raporti i KE-së gjithashtu konstatoi se Shqipëria kishte përmbushur të gjitha kushtet për Konferencën e parë Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimin, e cila u mbajt në mesin e vitit 2022, duke nënvizuar gjithashtu se në vitin 2021 pati progres të kufizuar në zbatimin e Udhërrëfyesit për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Shoqërinë Civile.

Qëndrueshmëria e përgjithshme e OSHC-ve nuk ndryshoi në vitin 2021, megjithëse pati përkeqësime të lehta në dimensionet e mjedisit ligjor, advokimit dhe imazhit publik. Mjedisi ligjor pësoi rënie për shkak të disa ndryshimeve në kuadrin ligjor për OSHC-të. Kufizimet e zgjatura mbi tubimet, transparencën e kufizuar dhe mungesën e mundësive për t'u konsultuar me qeverinë minuan iniciativat OSHC-ve për advokim, ndërkohë që imazhi publik i sektorit u përkeqësua pak si rezultat i sulmeve të vazhdueshme të qeverisë dhe mediave të ndikuara nga qeveria ndaj OSHC-ve dhe aktivistëve. Dimensionet e tjera të qëndrueshmërisë së OSHC-ve mbetën kryesisht të pandryshuara.

Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fund të vitit 2021 rezultoi në regjistruara 12,240 OSHC në nivel kombëtar. Gjatë vitit 2021 u regjistruan gjithsej 278 organizata të reja (156 shoqata, 73 qendra dhe 49 fondacione). Sipas institucioneve tatimore, 2,217 OSHC kanë qenë aktive financiarisht gjatë vitit 2021.

MJEDISI LIGJOR: 3.8



Gjatë vitit 2021, qeveria ndërmori disa ndryshime në mjedisin ligjor të OShC-ve që çuan në një përkeqësim të lehtë të rezultatit për këtë tregues.

Në qershor 2021, qeveria miratoi Ligjin Nr. 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse si pjesë e një grupi të gjerë masash kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. OShC-të kryesisht u përjashtuan nga konsultimet gjatë fazës së hartimit të ligjit. Në parim, sektori e mirëpriti nismën, e cila synon të përmirësojë mjedisin mundësues dhe transparencën e OShC-ve duke thjeshtuar procedurat e regjistrimit dhe duke krijuar një regjistër *online* të OShC-ve. Megjithatë, 119 OShC ngritën shqetësime serioze mbi ligjin, duke argumentuar se i jep qeverisë kompetenca të paqarta që do të kishin një efekt dekurajues për shoqërinë civile,

veçanërisht për organizatat e fokusuara në llogaridhënien publike. Në gusht të vitit 2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor i Shqipërisë, i caktuar nga ligji për të krijuar regjistrin *online* të OShC-ve, u shpreh se nuk mund ta bënte këtë për shkak të mungesës së fondeve të parashikuara për këtë qëllim. Si rezultat, regjistri nuk u krijua deri në fund të vitit.

Ligji gjithashtu dështoi të pasqyronte rekomandimet e shoqërisë civile në lidhje me masat e nevojshme për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave të përfshira në regjistrin *online* të OShC-ve. OShC-të e panë këtë si veçanërisht shqetësuese duke marrë parasysh rrjedhjet serioze të të dhënave që ndodhën në vitin 2021 nga bazat e të dhënave qeveritare të menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ku pagat, preferencat e supozuara politike dhe informacione të tjera sensitive të qytetarëve shqiptarë u shpërndanë në publik.

Veprimet e përditshme të OShC-ve ende pengohen nga ritmi i ngadaltë i procedurave të nevojshme gjyqësore. Për shembull, në bazë të Ligjit Nr. 8788 për Organizatat Jofitimprurëse, OShC-ve u kërkohet të njoftojnë çdo ndryshim në statutet e tyre të brendshme ose procedurat e qeverisjes në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Gjatë vitit 2021, afatet kohore të ofrimit të shërbimeve gjyqësore u përkeqësuan, me shumë gjasa për shkak të dinamikës së reformës në drejtësi që ka ulur numrin e gjyqtarëve dhe ka rritur ngarkesën e punës së gjykatave.

Përtej Barrierave, një OShC e fokusuar në edukimin joformal të të rinjve, përgjatë vitit 2021 zhvilloi konsultime me rrjetet të OShC-ve mbi kornizën ligjore për vullnetarizmin. Gjatë këtyre konsultimeve, OShC-të identifikuan disa sfida të rëndësishme, përfshirë mungesën e një kornize për të njohur ligjërisht punën vullnetare, kontratën e vullnetarëve, llogaritjen e vlerës së kontributeve shoqërore të vullnetarëve, si dhe mungesën e qartësisë rreth regjistrin të vullnetarëve. Në janar, Partnerët Shqipëri (PSH) publikoi një analizë të kornizës ligjore për vullnetarizmin e cila theksoi nevojën për të hequr barrierat formale për vullnetarizmin, detyrimet e rënda financiare për vullnetarët dhe kërkesat e regjistrimit për ofrimin e shërbimeve të vullnetarizmit.

Neni 262 i Kodit Penal kërkon autorizim paraprak për zhvillimin e tubimeve. Megjithatë, sipas Avokatit të Popullit, leja paraprake për mbajtjen e tubimit nuk duhet të kërkohet, pasi një njoftim i thjeshtë mjafton për t'i mundësuar autoriteteve shtetërore të menaxhojnë tubime të tilla, duke garantuar rendin publik dhe mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Në maj, Gjykata Kushtetuese vendosi se kërkesa për autorizim paraprak për tubime ishte antikushtetuese, duke hequr kështu bazën kryesore për ndjekjen penale të pjesëmarrësve në tubime të "paautorizuara".

Megjithatë, në të njëjtën kohë, Komiteti Teknik i Ekspertëve që zbaton masat për të luftuar pandeminë COVID-19 vazhdoi të kufizojë tubimet. Mosrespektimi i këtyre kufizimeve gjobitej me 5 milionë ALL (përafërsisht USD 48,000). Megjithatë, policia aplikoi sanksione në mënyrë arbitrare, duke lejuar disa tubime elektorale dhe tubime të tjera publike, ndërsa disa të tjera i ndaloi. Katër organizatorë u arrestuan dhe 30 protestues u akuzuan penalisht për organizimin dhe pjesëmarrjen në protestën kundër ndërtimit të një hidrocentrali në Mirditë; nëntë naftëtarë u akuzuan penalisht për pjesëmarrje në një protestë në Ballsh; dhe dy kandidatë të pavarur në zgjedhjet parlamentare u gjobitën për organizimin e tubimeve publike gjatë fushatës zgjedhore.

Disa forma të ngacmimeve shtetërore vazhdojnë ende. Organizata që marrin fonde nga qeveria shpesh shmangin kritikimin publik të veprimeve të qeverisë pasi kanë frikë se do të humbasin fondet. OShC-të kanë vënë në dukje se taktikat si *trolling* në internet dhe telefonatat për të ushtruar presion vazhdojnë të jenë problem. Për më tepër, inspektimet e shpeshta dhe shpesh të pakoordinuara nga autoritetet e shërbimit social dhe inspektorët e punës janë problematike për organizatat që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e dhunës dhe trafikimit, pasi këto organizata hezitojnë t'ua ekspozojnë listat e marrësve të shërbimit palëve të treta.

Në shtator, Këshilli i Ministrave nxori një vendim për krijimin e Agjencisë për Media dhe Informim. Kjo agjenci synon të centralizojë vendimmarrjen për të gjitha paraqitjet në media, publikimet dhe kërkesat për informacion të përpunuara nga pushteti ekzekutiv. Organizatat e medias dhe shoqëria civile ngritën shqetësimin se kjo agjenci do të përdoret për të rritur kontrollin e qeverisë dhe për të kufizuar transparencën, në vend që të avancojë të drejtën e publikut për informim.

Në dhjetor 2021, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikoi projekt-amendamentet e Ligjit Nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit. Gazetarët dhe OShC-të kritikuan disa aspekte të draft-amendamenteve, të cilat aktualisht janë duke kaluar në konsultim publik. Për shembull, projekt-amendamentet përjashtojnë gjykatat dhe prokurorët nga fusha e veprimit të ligjit, gjë që dëmton të drejtën e publikut për të marrë informacion nga këta aktorë të rëndësishëm publikë.

Mundësitë ligjore për OShC-të për të mobilizuar burime financiare nuk ndryshuan gjatë vitit 2021. Një OShC mund të ndërmarrë aktivitet ekonomik për të gjeneruar të ardhura, me kusht që të ardhurat të mos përbëjnë më shumë se 20 përqind të buxhetit të saj të përgjithshëm vjetor. Ligji Nr. 7892 mbi Sponsorizimin njeh donacionet e korporatave si shpenzime të zbritshme në kushte të caktuara. Individëve vazhdojnë t'u mungojnë stimujt tatimorë për t'iu dhuruar OShC-ve. Taksat vendore, si taksat mbi pronën dhe taksat mjedisore, janë një barrë e konsiderueshme për financat e organizatave, veçanërisht atyre që merren me ofrimin e shërbimeve.

Sipas Ligjit Nr. 92/2014 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), grantet përjashtohen nga TVSH-ja nëse ato përdoren për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të një organizate dhe organizata nuk ofron mallra ose shërbime për donatorët në këmbim të grantit. Përveç kësaj, si subjekte të tatueshme, OShC-të kanë të drejtë të rimbursojnë TVSH-në në kushte të caktuara. Megjithatë, procesi i rimbursimit të TVSH-së për projektet e OShC-ve mbetet ende një sfidë për sektorin. Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rimbursoi TVSH-në për katër projekte të OShC-ve në të gjithë vendin, gjë që u pa si një progres i moderuar. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKBSHC) zhvilloi aktivitete ndërgjegjësuese dhe trajnime për njohjen e OShC-ve me procedurën e rimbursimit të TVSH-së për grantet e huaja.

OShC-të kanë akses të kufizuar në ekspertizë të specializuar ligjore, e cila është kryesisht e përqendruar brenda Tiranës.

KAPACITETI ORGANIZATIV: 3.6

Kapaciteti organizativ i OShC-ve nuk ndryshoi në vitin 2021.

Sfidat organizative si mungesa e burimeve, infrastrukturës dhe një kulture pune, vazhduan të prekin në mënyrë disproporcionale organizatat më të vogla lokale dhe rurale. Shumica e OShC-ve të themeluara operojnë në Tiranë dhe kanë më shumë burime. OShC-të lokale zakonisht kanë akses të kufizuar në financim dhe kapital njerëzor, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të zhvilluar kapacitetet e tyre organizative. Kjo përforcohet nga praktika e vazhdueshme e donatorëve ndërkombëtarë që kanalizojnë pjesën më të madhe të mbështetjes së tyre tek OShC-të më të mëdha dhe të mirëkonsoliduara. Për më tepër, shumë OShC-ve u mungojnë fondet bazë për të mbështetur nevojat e tyre operationale dhe për t'i lejuar ato të bëhen të qëndrueshme.



OShC-të në nivel lokal prirën të krijojnë lidhje më të forta dhe më të qëndrueshme me komunitetet e tyre sesa organizatat kombëtare. Megjithatë, përdorimi në rritje i mjeteve dixhitale ka ofruar një mundësi për të mbajtur marrëdhënie më të ngushta dhe për të përfshirë përfuturit fundor në aktivitetet e OShC-ve dhe hartimin e projekteve. Për shembull, gjatë vitit 2021, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) u konsultua me 500 aktorë lokalë për të hartuar dhe advokuar politika të reja rreth qeverisjes së sektorit rural.

Si rezultat i disa programeve të donatorëve që synojnë të ndërtojnë kapacitetet organizative të OShC-ve, këto të fundit janë angazhuar gjithnjë e më shumë në planifikim strategjik, hartim të programeve dhe zhvillim të misioneve të mirëpërcaktuara. Këto përmirësime ishin më të dukshme tek OShC-të që operojnë në zona të mëdha urbane. Megjithatë, përcaktimi i misionit dhe planifikimi strategjik janë shpesh dytësore për OShC-të në krahasim me prioritetet ose agjendat aktuale të donatorëve. Pezullimi ose reduktimi i burimeve të ndryshme të financimit për shkak të pandemisë COVID-19 rriti varësinë e disa organizatave në një ose pak donatorë, duke i bërë ato të përqendrohen vetëm tek aktivitetet me interes për atë donator.

OShC-të kanë struktura të brendshme të menaxhimit dhe përcaktojnë qartë në statutet e tyre ndarjen e përgjegjësi ndërmjet stafit dhe anëtarëve të bordit. Megjithatë, këto struktura janë kryesisht formale dhe të krijuara për të përmbushur kërkesat ligjore, në vend që të rregullojnë aktivitetet e përditshme të shumë organizatave. Ndër të tjera, organizatat kombëtare si Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri, Fondacioni Shoqëria e Hapur - Shqipëri dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ndërveprojnë në mënyrë aktive me bordet e tyre. Kërkesat e donatorëve gjithashtu kanë nxitur shumicën e OShC-ve që të miratojnë politika dhe procedura të brendshme organizative për të menaxhuar veprimtarinë e tyre.

Efektet e zgjatura të pandemisë dhe financimi i bazuar kryesisht në projekte kufizuan aftësinë e OShC-ve për të punësuar staf të përhershëm dhe për të paguar pagat e stafit në vitin 2021. Sipas të dhënave nga Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2020, sektori i shoqërisë civile punësoi 9793 persona në vitin 2020. Një raport për vitin 2020 nga Fondacioni Evropian i Trajnimit tregoi se shumica e OShC-ve të anketuara në Shqipëri (61 përqind) kanë nga një deri në katër punonjës dhe bashkëpunëtorë të paguar dhe vetëm 7 përqind kanë nga pesëmbëdhjetë deri në dyzet e nëntë personel dhe bashkëpunëtorë me pagesë. Aftësia e OShC-ve për të mbajtur stafin dhe për të punësuar profesionistë cilësorë u ndikua negativisht nga fenomeni gjithnjë e më i përkeqësuar i "largimit të trurit" (*brain drain*), pasi profesionistët e rinj migrojnë në vendet e zhvilluara për paga më të larta dhe cilësi më të mirë jetese.

Sipas Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2020, 42 përqind e OShC-ve të anketuara angazhuan nga një deri në dhjetë vullnetarë dhe vetëm 2 përqind angazhuan më shumë se 300 vullnetarë. Megjithatë, korniza ligjore në Shqipërisë e mbirregullon sektorin dhe e bën të vështirë që OShC-të të përfshijnë vullnetarë në aktivitetet e tyre. Në maj të vitit 2021, Përtej Barrierave dhe Qendra për Progres dhe Zhvillim mbajtën Konferencën e parë Kombëtare të Vullnetarizmit në Shqipëri për të krijuar një platformë kombëtare mbi vullnetarizmin. Pjesëmarrësit e konferencës propozuan krijimin e standardeve për të ndihmuar organizatat të krijojnë dhe menaxhojnë sisteme të qëndrueshme për angazhimin vullnetar.

Ndërkohë që disa OShC shfrytëzuan përdorimin e mjeteve të reja dixhitale për të përballuar sfidat e pandemisë, shumë organizata nuk përvetësuan përmirësime teknologjike apo inovacione domethënëse, qoftë për shkak të mungesës së fondeve ashtu edhe për shkak të mungesës së dukshme të vullnetit të OShC-ve për të përqafuar dixhitalizimin. OShC-të zakonisht përdorin platforma të mediave sociale si Facebook ose Twitter për të lehtësuar veprimtarinë e tyre. Sidoqoftë, ato rrallë përdorin platforma ose programe të menaxhimit dhe ndjekjes së projekteve për të koordinuar dhe standardizuar punën midis anëtarëve të projektit.

QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE: 4.5

Qëndrueshmëria financiare e OShC-ve mbeti kryesisht e pandryshuar në vitin 2021, pasi u ndikua nga zhvillime si pozitive ashtu dhe negative.

Sipas Raportit të KE-së për Shqipërinë për vitin 2021, pandemia COVID-19 dobësoi më tej qëndrueshmërinë financiare të sektorit të shoqërisë civile, e cila është rënduar prej kornizës së pafavorshme ligjore dhe fiskale në Shqipëri. Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2020 informoi se trajtimi fiskal i sektorit, duke përfshirë mungesën e rimbursimit të TVSH-së për grantet, vazhdon të ndikojë negativisht në

QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE NË SHQIPËRI



operacionet dhe aktivitetet e OShC-ve. Nuk është bërë përparim në adresimin e masave në lidhje me trajtimin financiar dhe tatimor të OShC-ve të parashikuara nga Udhërrëfytyruesi për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Shoqërinë Civile 2019 – 2023.

Donatorët e huaj, përfshirë institucionet e Bashkimit Evropian, ambasadat e huaja, agjencitë e zhvillimit dhe institutet e partive politike të huaja, vazhdojnë të jenë burimi më i rëndësishëm financiar për OShC-të në Shqipëri. Institucionet publike, në veçanti ministritë dhe bashkitë, janë gjithashtu një burim i rëndësishëm financimi.

Skemat e nëngrantimit mbetën një burim i rëndësishëm i mbështetjes financiare për OShC-të. Për shembull, PSH, me financim nga Ministria e Jashtme Norvegjeze, zbatoi

Programin për Shoqërinë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën; ky program publikoi thirrjen e tretë për propozime në maj të 2021 përmes së cilës pesë OShC morën gjithsej EUR 128,000. Me financim nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Lëviz Albania publikoi tetë thirrje për grante deri në CHF 60,000 (afërsisht USD 62,740) për OShC-të dhe grupet joformale dhe aktivistët që punojnë për të përmirësuar demokracinë vendore dhe llogaridhënien e qeverisë. Megjithatë, OShC-të theksojnë se fondet e vogla shpesh krijojnë barra administrative që pengojnë mundësinë e OShC-ve për të zhvilluar programet e tyre.

OShC-të marrin disa grante nga qeveria. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) ofron vetëm mbështetje minimale financiare për sektorin dhe nuk konsiderohet si një burim i qëndrueshëm financimi për OShC-të si pasojë e shkurtimeve buxhetore në vitet e fundit. Në prill, AMShC publikoi një thirrje për projekt propozime për mbështetje financiare deri në 2 milionë ALL për projekt (afërsisht USD 17,800). Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ofroi mbështetje për organizatat rinore në vitin 2021.

Ligji i ri për Prokurimin Publik hyri në fuqi në mars 2021 dhe u mundësoi OShC-ve që ofrojnë shërbime sociale të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik. Megjithatë, qeveria publikoi pak prokurime publike relevante për sektorin. Për rrjedhojë, pak OShC e shfrytëzuan këtë mundësi në vitin 2021. Sipas të dhënave të Agjencisë së Prokurimit Publik, vetëm shtatë organizata jofitimprurëse morën pjesë në thirrjet e prokurimeve publike dhe vetëm katër morën financim; këto ishin të fokusuar kryesisht në shërbimet bujqësore.

Gjatë vitit 2021, disa OShC eksperimentuan me *crowdfunding* për të plotësuar burimet tradicionale të financimit. Një shembull premtues ishte një nismë *crowdfunding* e ndërmarrë nga Down Syndrome Albania dhe platforma smile.al e PSH, e cila u krijua në bashkëpunim me sektorin privat dhe mbledhi fonde për pesë projekte.

Në janar të 2021, qeveria miratoi Ligjin për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare, i cili kërkon që të gjithë personat juridikë, përfshirë organizatat jofitimprurëse, të japin informacion në lidhje me llogaritë e tyre bankare me qëllim krijimin e një regjistri për të zbuluar, identifikuar dhe për të hetuar veprimtarinë kriminale. Një grup OShC-sh paraqitën një opinion ligjor për ligjin tek Ministria e Financave, i cili vuri në dukje shqetësime në lidhje me institucionin që do të administrojë regjistrin dhe të drejtën e institucioneve të tjera të interesuara për të marrë informacion nga ky regjistër pa miratimin paraprak të gjykatës. Megjithatë, këto rekomandime nuk u pasqyruan plotësisht në ligjin përfundimtar. Si rezultat, këto OShC argumentuan se ligji duhet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

OShC-të angazhohen gjithnjë e më shumë në ofrimin e shërbimeve, përfshirë sipërmarrjen sociale, për të diversifikuar të ardhurat e tyre. Ligji Nr. 10192/2009 lejon që asetet e konfiskuara të shndërrohen në pronë publike dhe mbështet një model efektiv të biznesit social gjithëpërfshirës për të ofruar shërbime, trajnime, punësim dhe mbështetje për grupet vulnerabël.

OShC-të janë gjithnjë e më të ndërgjegjshme mbi nevojën për të garantuar një menaxhim të mirë financiar të burimeve dhe granteve të tyre dhe për të rritur përputhshmërinë e tyre me kërkesat e donatorëve. Për këtë qëllim, OShC-të vazhdojnë të investojnë në sisteme më të sofistikuar të menaxhimit financiar dhe trajnime për stafin e tyre. Për shembull, akademia e OJF-ve e organizuar çdo vit nga QKBShC, i mundëson stafit financiar të

OShC-ve trajnime mbi menaxhimin financiar dhe procedurat e brendshme financiare, buxhetimin, kontabilitetin, sigurimin e mbështetjes financiare përmes granteve dhe detyrimet e raportimit.

ADVOKIMI: 3.3

Megjithëse OShC-të advokuan për një gamë të gjerë çështjesh në vitin 2021, mungesa e transparencës, konsultimet e rralla të qeverisë dhe kufizimet e vazhduara të COVID-19, kanë minuar mundësinë e OShC-ve për të ndikuar në politikat publike gjatë viteve të fundit, duke sjellë një përkeqësim të lehtë në këtë dimension.

Zgjedhjet parlamentare u mbajtën në prill 2021. Pavarësisht mundësisë së pakët për angazhim nën kufizimet e pandemisë, disa OShC monitoruan zgjedhjet në të gjithë vendin. Këta vëzhgues raportuan keqpërdorimin e burimeve shtetërore gjatë fushatës dhe parregullsitë gjatë ditës së votimit. Gjithashtu, OShC-të ndërmorën programe për edukimin e zgjedhësve, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtën e votës, reformën zgjedhore të miratuar në vitin 2020 dhe rëndësinë e pjesëmarrjes publike të komuniteteve të marginalizuara dhe të rinjve.

Sipas sondazhit të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) *Besimi në Qeverisje 2021*, më shumë se gjysma e shqiptarëve e perceptuan qeverinë qendrore dhe atë vendore si jo transparente gjatë vitit 2021. Seancat gjyqësore dhe takimet publike shpesh u mbajtën me dyer të mbyllura për shkak të masave kundër COVID-19, duke i mohuar aksesin gazetarëve dhe monitoruesve. Në vitin 2021, KShH u përjashtua nga Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, duke e lënë këtë të fundit pa përfaqësim të shoqërisë civile. Një raport monitorimi i publikuar nga IDM tregoi se programet e transparencës së bashkive mbeten të paplotësuara dhe se bashkitë janë më pak transparente sa i përket publikimit të informacionit mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Si shembull pozitiv, vijoi transmentimi i drejtpërdrejtë i punimeve të komisioneve parlamentare, si një praktikë e mirë për përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut dhe mbikëqyrjes së proceseve legislative.

Konsultimet publike me OShC-të mbetën kryesisht një formalitet me ndikim të kufizuar. Për shembull, një grup OShC-sh kritikuan konsultimet e pamjaftueshme dhe përdorimin e procedurës së përsheptuar nga Parlamenti për miratimin e një paketë ligjore për reformën në drejtësi, ndërsa dyzet e katër OShC dënuan publikisht konsultimet e mbajtura mbi planin e qeverisë për të ndryshuar hartën e zonave të mbrojtura mjedisore si një ushtrim të papërshtatshëm “të kryer sa për formalitet”. Parlamenti miratoi Rregulloren e re për Akreditimin, Akomodimin dhe Orientimin e Masmidiave pa kryer konsultime publike. Megjithatë, pas kritikave të OShC-ve dhe mediave për ndikimin e mundshëm negativ të rregullores tek transparenca, parlamenti u konsultua me grupet e interesit dhe rishikoi rregulloren.

Sipas një raporti të Res Publica, kohëzgjatja mesatare brenda së cilës institucionet iu përgjigjën kërkesave për informim shënoi rekordin e saj më të keq gjatë vitit 2021. Kërkesat për informim shpesh u pasuan nga procedura të zgjatura gjyqësore. Siç është përmendur më lart, organizatat vendore dhe ndërkombëtare e konsideruan Agjencinë për Median dhe Informim si një përpjekje për të konsoliduar kontrollin e qeverisë dhe për të kufizuar aksesin në informacion.

Në vitin 2021, OShC-të paraqitën disa nisma ligjvënëse në parlament. Për shembull, një koalicion OShC-sh propozoi një projektligj për krijimin e një regjistri kombëtar të personave të dënuar për krime seksuale, pasi mblodhi me sukses 22,428 nënshkrime nga qytetarët. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) përgatitën një projektligj për paditë kolektive, i cili më pas u paraqit për shqyrtim parlamentar nga një deputet, me kërkesë të përbashkët të shtatëdhjetë e tre OShC-ve. KShH i ofroi asistencë teknike Sindikatës së Fermerëve për përgatitjen dhe dorëzimin e propozimit për ndryshime në ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural si dhe në ligjin për TVSH-në. Asnjë nga nismat ligjvënëse të sipërpërmendura nuk janë miratuar ende nga parlamenti.



OShC-të vijuan përpjekjet e tyre për advokim përmes fushatave publike, peticioneve dhe mjeteve të tjera të angazhimit. Një peticion *online* i lançuar nga Eco Albania për shpalljen e lumit Vjosa park kombëtar, mori mbi 50,000 nënshkrime dhe mbështetje të gjerë kombëtare dhe ndërkombëtare, megjithatë, qeveria nuk ndërmori ndonjë masë gjatë vitit 2021. Përballja e Ofertave Politike (POP), një rrjet prej dymbëdhjetë OShC-sh që punojnë për të promovuar llogaridhënien dhe angazhimin qytetar në nivel vendor, organizoi fushata në shumë bashki duke advokuar për zbatimin e prioriteteve të politikave të zgjedhura nga komuniteti në fushat e shërbimeve publike, demokracisë vendore dhe qeverisjes së mirë, zhvillimit ekonomik dhe çështjeve sociale të zonës. Si rezultat i kësaj, pesë bashki u angazhuan të adresojnë kërkesat e komunitetit në vitin 2022. IDM zhvilloi ushtrimin e parë kombëtar të anketimit deliberativ, i cili shqyrtoi perceptimet e 1,200 qytetarëve për çështje me interes publik dhe zgjidhjet e mundshme. IDM do t'i paraqesë gjetjet e hulumtimit në parlament për të informuar vendimmarrjen legjislative.

Së fundi, OShC-të përdorën litigimin strategjik për të adresuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të sfiduar vendime të debatuar të qeverisë. Pas publikimit të një databaze me të dhënat personale e 910,000 zgjedhësve në prag të zgjedhjeve parlamentare, Guxo, një organizatë rinore, ngriti padi kundër Partisë Socialiste në emër të 162 qytetarëve si dhe depozitoi një ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Res Publica ofroi përfaqësim ligjor për median që raportoi për herë të parë mbi databazën, pasi Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) urdhëroi sekuestrimin e serverëve të saj kompjuterik. Res Publica e dërgoi çështjen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila e urdhëroi SPAK të ndalonte sekuestrimin. Urdhri i GJEDNJ-së u zbatua më pas edhe nga gjykatat shqiptare, duke vendosur kështu një precedent të rëndësishëm për mbrojtjen e burimeve gazetareske. Gjithsesi, deri në fund të vitit 2021, askush nuk mbajti përgjegjësi ligjrisht për këtë incident.

KShH sfidoi me sukses kushtetutshmërinë e dispozitave të Ligjit për Policinë e Shtetit që lejonin përgjimin e paautorizuar, të cilat Gjykata Kushtetuese i gjeti në cënim të të drejtës për jetë private. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ngriti një padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për të kundërshtuar refuzimin e gjendjes civile për të regjistruar si prindër një çift lezbikesh, e cila rezultoi e pasuksesshme. TLAS planifikon ta apelojë këtë vendim dhe të kërkojë shfuqizimin e legjislacionit që u mohon të drejta të barabarta prindërore çiftëve të të njëjtit seks. Klinikat e ligjit të Fondacionit Shoqëria e Hapur - Shqipëri, i ofruan përfaqësim ligjor një komuniteti lokal në përpjekje për të parandaluar ndërtimin e dy hidrocentraleve në Parkun Kombëtar të Zall Gjoçaj. Në janar, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë shfuqizoi licencën që lejonte kompaninë private të prodhonte energji në njërin nga hidrocentralet. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Në korrik, Gjykata e Lartë pezulloi ndërtimin e dy hidrocentraleve të tjerë mbi lumin Valbonë si rezultat i një padie të ngritur gjashtë vite më parë nga Organizata për Ruajtjen e Alpeve Shqiptare (TOKA). OShC-të paraqitën disa ankesa pranë Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me të drejtat e komunitetit rom, egjiptian, personave me aftësi të kufizuara dhe personave LGBTI+, të cilat rezultuan të suksesshme.

Forumi Rinor Evropian e shpalli Tiranën Kryeqytetin Rinor Evropian për vitin 2022. Në kuadër të kësaj nisme, OShC-të rinore do të kenë mundësi të aplikojnë për financim projektesh në tetë fusha si promovimi i vullnetarizmit, inkurajimi i pjesëmarrjes aktive, promovimi i identitetit evropian, dhe rritja e investimeve për rininë.

OFRIMI I SHËRBIMEVE: 3.4

Ofrimi i shërbimeve nga OShC-të nuk ndryshoi ndjeshëm në vitin 2021

OShC-të mbeten ofruesit privatë kryesorë të shërbimeve sociale në vend. Gjatë vitit, ato ofruan shërbime të rëndësishme shëndetësore, psikologjike dhe strehim; ndihmë ligjore; shërbime edukative; dhe hulumtime. Roli i OShC-ve ishte veçanërisht i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve për komunitetin rom dhe egjiptian, personat LGBTI+, personat me aftësi të kufizuara, gratë viktime të dhunës në familje dhe trafikimit, fëmijët dhe të moshuarit. Për shembull, me financimin e UN Women, OShC-të ofruan shërbime, strehim, ndihmë ligjore dhe mbështetje socio-ekonomike për riintegrimin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe grave nga grupet vulnerabël. Për shkak të burimeve të kufizuara, shumë OShC u përqendruan në vazhdimësinë e aktiviteteve ekzistuese të shërbimit, në vend që të prezantonin shërbime të reja.

Me lehtësimin e kufizimeve të COVID-19 gjatë vitit 2021, OShC-të ishin në gjendje të ofronin shërbime në terren, duke rritur kështu efektivitetin e shërbimeve të tyre. Megjithatë, kufizimet e vazhdueshme mbi grumbullimet u



bënë pengesë për organizimin e aktiviteteve të caktuara. Sipas raportit të KE-së për vitin 2021, shërbimet e OShC-ve për personat vulnerabël të prekur nga pandemia plotësuan dhe ndonjëherë edhe zëvendësuan ndërhyrjet shtetërore.

Ofrimi i shërbimeve të OShC-ve varet shumë nga mbështetja e donatorëve dhe pak OShC gjenerojnë të ardhura përmes këtyre aktiviteteve, gjë që paraqet një sfidë për qëndrueshmërinë e tyre. Në përgjithësi, ndërmarrjet sociale në Shqipëri e kanë të vështirë të sigurojnë qëndrueshmëri dhe Fondi për Mbështetjen e Ndërmarrjeve Sociale nuk dha asnjë financim në vitin 2021.

Mbështetja e qeverisë për ofrimin e shërbimeve nga OShC-të është e pamjaftueshme. AMShC ofroi

mbështetje financiare të kufizuar për OShC-të që ofrojnë shërbime psiko-sociale për të rinjtë, të mbijetuarit e dhunës në familje, komunitetet e marginalizuara dhe personat që kanë kaluar COVID-19. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ofroi një mbështetje prej EUR 154,000 nga asete kriminale të sekuestruara për shtatë OShC që ofrojnë shërbime për viktimat e krimit dhe trafikimit. Ministria e Drejtësisë (MD) alokoi EUR 66,000 për mbështetjen e programeve të ndihmës juridike të OShC-ve dhe në mars 2021, dhjetë OShC aplikuan për këtë financim. Megjithatë, asnjë nga këto OShC nuk u përzgjedh dhe MD nuk i shpërndau këto fonde në vitin 2021. Një hap pozitiv në këtë drejtim ishte që MD filloi hartimin e një metodologjie për të vlerësuar aplikimet për projekte dhe për të përmirësuar procesin e financimit.

Në nivel vendor, bashkitë kanë buxhete minimale për kujdesin social, ndaj mbështetja që ofrojnë për OShC-të është e kufizuar. Të dhënat dhe studimet mbi nevojat për shërbime specifike në nivel vendor mungojnë dhe ndonjëherë duhet të sigurohen nga vetë OShC-të kur aplikojnë për fonde publike. Qeveria ofroi mbështetje nëpërmjet Fondit Social për gjashtëmbëdhjetë nga gjashtëdhjetë e një bashkitë e vendit. Disa bashki e përdorën këtë fond për të mbështetur financiarisht shërbimet e ofruara nga OShC-të. Megjithatë, OShC-të ngritën shqetësime mbi mungesën e transparencës, nepotizmin, vonesat në aksesimin e fondeve dhe përpjekjet e qeverisë për të ndikuar në vendimmarrjen e brendshme të OShC-ve që përfitojnë nga kjo mbështetje.

INFRASTRUKTURA E SEKTORIT: 3.6

Infrastruktura që mbështet sektorin e OShC-ve mbeti kryesisht e pandryshuar në vitin 2021. Shumica e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të sektorit vijuan të organizoheshin *online*, megjithatë, OShC-të filluan të zhvillojnë disa aktivitete me pjesëmarrje fizike ndërsa masat për COVID-19 lehtësoheshin.

QKBSHC vijoi të ofrojë trajnime dhe asistencë teknike për OShC-të. Në vitin 2021, QKBSHC organizoi sërish akademinë e saj të përvitshme të OJF-ve, përmes së cilës njëzet e tre drejtorë dhe menaxherë organizatash nga tetë qytete të Shqipërisë morën trajnime për qeverisjen e brendshme të organizatave, menaxhimin e burimeve njerëzore, komunikimin dhe planifikimin strategjik, advokimin dhe lobimin, ngritjen e fondeve dhe menaxhimin financiar. QKBSHC organizoi gjithashtu sesione informuese *online* mbi procesin e fiskalizimit (raportimi elektronik i faturave); regjistrimin e pronarit përfitues; dhe kuadrin fiskal dhe procedurat e rimbursimit të TVSH-së për OShC-të. Më tej, QKBSHC publikoi materiale informuese për të rritur ndërgjegjësimin për ndryshimet ligjore që prekin OShC-të dhe ofroi asistencë



teknike për katër rrjete dhe koalicione të reja të OShC-ve për konsolidimin e brendshëm, planifikimin strategjik, advokimin, lobimin, ngritjen e fondeve dhe bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese.

OShC-të gjithashtu patën akses në mundësi të shumta trajnimi të ofruara nga organizata të tjera. IDM trajnoi nëntëdhjetë përfaqësues të OShC-ve lokale dhe aktivistë për mekanizmat e pjesëmarrjes në proceset parlamentare dhe njëzet e katër OShC për kuadrin kundër pastrimit të parave në Shqipëri. Më tej, IDM trajnoi gjashtë përfitues të granteve për monitorimin e reformës në administratën publike dhe metodat e konsultimit publik në BE, si dhe për menaxhimin dhe raportimin e projekteve. Lëviz Albania mentoroi përfituesit e granteve të saj mbi përdorimin e mjeteve inovative dhe kreative të advokimit. Qendra Ndërkombëtare Olof Palme (OPIC) ofroi asistencë tematike dhe mentorim për OShC-të partnere në lidhje me planifikimin strategjik, advokimin dhe komunikimin, menaxhimin e brendshëm dhe ndërtimin e koalicioneve, si dhe organizoi aktivitete për OShC-të partnere me qëllim shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare. Rrjeti Shqiptar i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) i trajnoi OShC-të mbi procesin e fiskalizimit, analizën gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore. PSH ndërmori një iniciativë të re për të forcuar aftësitë e OShC-ve për *crowdfunding*. EDEN ofroi trajnime për OShC-të mbi dilgjencën mjedisore në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. EDEN gjithashtu trajnoi OShC-të mbi komponentët e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Disa organizata ofruan mbështetje për OShC-të duke nëngrantuar fondet e donatorëve ndërkombëtarë. AWEN ofroi njëzet e pesë grante për OShC-të që punojnë për promovimin e barazisë gjinore dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore, me financim nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. OPIC, me mbështetjen e Sida, ofroi trembëdhjetë grante për OShC-të, sindikatat dhe një rrjet të OShC-ve të fokusuar tek të drejtat e njeriut, demokracia vendore, qeverisja e mirë dhe të rinjtë. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe PSH ofruan pesë grante për OShC-të për aktivitete në fushën e medias, anti-diskriminimit, anti-korrupsionit dhe mjedisit, përmes një programi të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze. Lëviz Albania, me mbështetjen e SDC, dha pesëdhjetë e dy grante për OShC-të dhe aktorë të tjerë civilë joformalë, për iniciativa advokimi dhe angazhim në nivel vendor, duke përfshirë mbështetje për rrjetëzim dhe ndërtim aleancash ndërmjet aktorëve civilë. Qendra Burimore e Mjedisit, përmes një programi të mbështetur nga Fondi Global i Mjedisit, ofroi grante të vogla për dhjetë OShC dhe *startup*-e të reja të udhëhequra nga gra që promovojnë produkte të gjelbra. Civil Rights Defenders, me mbështetjen e Sida, ofroi tre grante për OShC që punojnë me çështjet e medias, si dhe të drejtat e romëve dhe egjiptianëve. Vërehet një zhvillim pozitiv, pasi disa organizata kanë filluar të promovojnë ndërtimin e koalicioneve dhe rrjetëzimin e OShC-ve përmes programeve të tyre të granteve.

OShC-të vijuan të bashkëpunojnë, të ndërmarrin aksione të përbashkëta dhe të ndërtojnë rrjete për të rritur ndikimin dhe vizibilitetin e tyre. Gjatë vitit 2021, anëtarësimi në ANRD u rrit si tematikisht ashtu edhe gjeografikisht. Kjo rriti ndikimin e Parlamentit Rural të Shqipërisë - një event advokimi dhe rrjetëzimi i organizuar në mars të vitit 2021 nga ANRD - duke siguruar pjesëmarrjen e 600 aktorëve vendorë të cilët u mbledhën për të diskutuar sfidat e zhvillimit bujqësor dhe rural. Gjithashtu, OShC-të u angazhuan gjithnjë e më shumë në aksione të përbashkëta me grupet joformale të aktivistëve. Gjatë vitit, për shembull, disa aktivistë dhe OShC punuan së bashku për të organizuar protesta mbarëkombëtare kundër dhunës me bazë gjinore, duke sinjalizuar fillimin e një lëvizjeje feministe. Aktivistët e mjedisit morën mbështetje të vazhdueshme nga OShC-të në betejat e tyre ligjore dhe protestat kundër ndërtimeve të konsideruara si të dëmshme për mjedisin.

Bashkëpunimi ndërmjet OShC-ve dhe qeverisë qendrore apo asaj vendore mbeti i pamjaftueshëm ndërsa OShC-të nuk besojnë se kontributi i tyre merret parasysh nga institucionet. Megjithatë, një hap pozitiv në këtë drejtim ishte bashkëpunimi i OShC-ve përgjatë vitit me institucionet e pavarura, mediat lokale dhe universitetet, për të shkëmbyer informacion, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe për të rritur vizibilitetin e kauzave të ndryshme. Për shembull, OShC-të bashkëpunuan me universitetet gjatë periudhës zgjedhore për të organizuar aktivitete informuese mbi votimin për studentët. Megjithëse bashkëpunimi ndërmjet OShC-ve dhe sektorit privat mbeti i pazhvilluar në vitin 2021, një shembull pozitiv u pa në bashkëpunimin midis IDM dhe sektorit privat në kuadrin e rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të aktorëve joshitetorë mbi kuadrin e politikave kundër pastrimit të parave.

IMAZHI PUBLIK: 3.8



Imazhi publik i sektorit të OShC-ve u përkeqësua pak në vitin 2021 si rezultat i sulmeve të vazhdueshme përgjatë viteve të fundit të qeverisë dhe mediave të ndikuara prej saj ndaj sektorit.

Qeveria shpesh dëmtoi besueshmërinë dhe imazhin e shoqërisë civile dhe lëvizjeve joformale. Raporti *Vendet në Tranzicion 2022* i Freedom House, ndër të tjera, vuri në dukje se gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021 pati fushata të egra kundër aktivistëve, reporterëve dhe shoqërisë civile. Këto fushata u karakterizuan nga një gjuhë diskriminuese, mizogjini, frikësim, kërcënim, madje edhe dhunë. Për shembull, aktivistët e të drejtave të njeriut që advokuan për ndryshime në ligjet që prekin komunitetin LGBTI+ shpesh ishin subjekt i fyerjeve dhe kërcënimeve homofobike. Përveç kësaj, bashkëautorët e

një studimi mbi kapjen e shtetit dhe korrupsionin në Shqipëri, të publikuar nga Transparency International dhe IDM, u sulmuan në media në përpjekje për të zhvendosur vëmendjen nga gjetjet e studimit.

Mbulimi mediatic dhe diskursi publik gjatë vitit u përqendrua në mënyrë disproporcionale tek partitë politike dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 në raport me aktivitetet e shoqërisë civile. OShC-të e konsoliduara e tërheqin vëmendjen e medias, ndërsa mediat tradicionale rrallë herë mbulojnë OShC-të që punojnë me grupet e marginalizuara si komuniteti rom, gjë që dëmton mundësinë e këtyre OShC-ve për të tërhequr vëmendjen e publikut. OShC-të gjithashtu patën mbulim mediatic vendas dhe ndërkombëtar lidhur me protestat që organizuan për çështje të ndjeshme si rritja e çmimeve, dhuna në familje dhe të drejtat e LGBTI+.

Sipas sondazhit të IDM-së *Besimi në Qeverisje 2021*, publiku i perceptoi OShC-të si institucionin e katërt më të besuar në vend, me 52.6 përqind të të anketuarve që u shprehën se u besojnë OShC-ve, pas institucioneve fetare (67 përqind), institucioneve arsimore (57.1 përqind) dhe forcave të armatosura (54,6 përqind). Këto rezultate janë të ngjashme me ato të një viti më parë. Më shumë se gjysma e të anketuarve besonin se media dhe OShC-të rrisin llogaridhënien e qeverisë. OShC-të u perceptuan gjithashtu si një nga institucionet më të pavarura nga interesat politike.

Imazhi pozitiv i sektorit të OShC-ve u arrit pjesërisht nga mbështetja e lëvizjeve të gjelbra që advokojnë për mbrojtjen e biodiversitetit dhe komuniteteve lokale që preken nga projekte të mëdha infrastrukturore si aeroportet apo hidrocentralet. Për shembull, lëvizja mbrojtjen e Vjosës, lumit të fundit të egër në Evropë, mobilizoi një mbështetje të konsiderueshme tek qytetarët. Eco Albania advokoi dhe ndikoi në perceptimin e qytetarëve mbi këtë çështje përmes fushatave dhe peticioneve inovative në internet.

Sektori privat shfaqti një vlerësim në rritje të rëndësisë së OShC-ve, veçanërisht për çështje të ndërlidhura si promovimi i sipërmarrjes sociale, filantropisë dhe asaj kundër pastrimit të parave.

Pandemia e COVID-19 nxiti OShC-të të rrisin praninë e tyre në internet. OShC-të përdorën më me aftësi mediat sociale dhe mjetet e tjera dixhitale për të promovuar aktivitetin e tyre dhe për të arritur grupet e synuara. Ky trend është më i dukshëm në OShC-të që operojnë në Tiranë dhe zona të mëdha urbane.

Në korrik, QKBSHC publikoi Kodin e Standardeve për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri, një mekanizëm vetërregullues që synon të përmirësojë efektivitetin, mirëqeverisjen, transparencën dhe llogaridhënien e organizatave jofitimprurëse. Kodi është modeluar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rajonale për OShC-të. Duke shfaqur përkushtim ndaj një mekanizmi rigoroz vetërregullues, OShC-të shpresojnë se Kodi i Standardeve do të nxisë të mësuarit dhe ndryshimin brenda sektorit, do të konsolidojë partneritetin midis sektorit dhe palëve të tjera të interesuara dhe do të rrisë legjitimitetin dhe besueshmërinë e OShC-ve.

Shënim: Mendimet e shprehura janë të panelistëve dhe hulumtuesve të projektit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose FHI 360.

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

1300 Pennsylvania Avenue, NW

Washington, DC 20523

Tel: (202) 712-0000

Fax: (202) 216-3524

www.usaid.gov